

## INTERVISTA

Anna Kohen, gruaja nga Vlora me origjinë hebreje, është prej kohësh në krye të iniciativave për të ndihmuar shqiptarët kudo që ndodhen. Puna e saj ka pasur një impakt të ndjeshëm gjatë luftës së Kosovës, por edhe në ngjarjet aktuale të shqiptarëve si tragjedia e Gërdecit, por dhe përmbytjet në Shkodër. Anna Kohen rrëfen në këtë intervistë jetën e saj dhe punën e palodhur në krye të organizatës "Motrat Qiriazhi" në SHBA...

Admirina Peçi

Një vajzë hebreje, e rritur në një nga rrugët e famshme të Vlorës. Çapëne dhe romantike njëkohësisht. Anna Kohen edhe pse është larguar prej më shumë se 20 vjetësh nga Shqipëria, është e lidhur ngushtësisht me këtë vend. "Shqiptarët i shpëtuan prindërit e mi hebrej gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në Vlorë unë kam kaluar ditët më të bukura të rinisë. Kam atje kujtime të mrekullueshme...". Kështu thotë doktorshë Anna, e vlerësuar para pak vitesh si 'Qytetare Nderi' e Vlorës, gruaja e cila e ka vënë jetën e saj në shërbim të shqiptarëve kudo që janë dhe i ndihmon ata sa herë i jepet rasti përmes Organizatës së grave shqiptaro-amerikane, "Motrat Qiriazhi", të cilën e drejton që nga viti 1999. Ky rrëfim për jetën e saj është mjaft tërheqës...

**Dr. Anna, prej vitesh ju drejtoni organizatën "Motrat Qiriazhi" në Amerikë. Si u gjendët ju në këtë pozicion? Si është krijuar kjo organizatë dhe si funksionon?**

Organizata e grave shqiptaro-amerikane "Motrat Qiriazhi", është themeluar në vitin 1993. Fillimisht ishte me një veprimtari të kufizuar në ndihmë të femijëve të Kosovës, që me anë të ndonjë aktiviteti të mbledheshin para për ta. Në atë kohë unë e mbështeta këtë organizatë, e ndihmoja duke mbledhur ndihma dhe duke vajtur në aktivitete që bëheshin një ose dy herë në vit. Në vitin 1999 unë u zgjodha presidente e kësaj organizate. Më dukej e pabesueshme, por e mora përsipër organizatën, ku arrita të marr edhe statusin nga qeveria si organizatë jo fitimprurëse, por ishte pa adresë dhe pa fonde. Zgjedhja ime si presidente coincidoi me luftën e Kosovës. Organizata funksionoi nga zyra ime, dhe me punën e palodhshme isha në një fushatë intensive për të mbledhur fonde dhe ndihma të tjera materiale për të ndihmuar të ikurit e luftës nga Kosova që jetonin në çadra në Shqipëri. Mblodhëm 144.000 dollarë dhe i dërguam në tri organizata në Shqipëri dhe Kosovë, duke përfshirë edhe familjet shqiptare që mbanin ato kosovare. "Motrat Qiriazhi" vazhdohte punën me vullnetarë, edhe pse unë nuk e shihja të arsyeshme që ne po bënim gjithë atë punë dhe nuk kishim fonde. Delina Fico bëri draftin e parë të propozimit edhe unë mora një konsultantë më vonë dhe mbaruam propozimin, e dërguam në Washington tek qeveria amerikane, ku pas miratimit morëm fonde për 4 vjet, nga ORR (Office of Refugee Resettlement). Më pas, organizata u vendos në zyrë me të gjitha akseset e saj, fillimisht me një punonjëse dhe më pas numri erdhi duke u rritur deri në 12. Përveç kësaj, me punën dhe programet tona morëm fonde edhe nga shumë fondacione të njohura në Amerikë. Ngjarjet e 11 Shtatorit 2001 ndikuan shumë edhe në funksionimin e mjaft organizatave jofitimprurëse. Gradualisht fondet filluan të pakësoheshin, duke e reduktuar ekipin e punës dhe më pas duke e mbajtur organizatën vetëm në bazë të vullnetarëve. Por, i gëzohem faktit se kurrë nuk na kanë munguar vullnetarët. Me punën e tyre ne kemi arritur të zgjidhim mjaft probleme në komunitetin tonë.

**Nga organizata "Motrat Qiriazhi" çdo**

# Anna Kohen

## "Jam e lumtur për shqiptarët... nuk vuajnë më nga sëmundja e komunizmit"

**vit jepen tituj nderi për personalitete të botës së gruas shqiptare. Shpesh janë personazhe mjaft të njohur, si rasti i soprano Inva Mula, apo edhe Donika Bardha, që para pak ditësh u akordua titulli "Gruaja e Vitit 2010". Çfarë impakti ka ky vlerësim në veprimtarinë e këtyre grave të suksesshme?**

Organizata e gruas shqiptaro-amerikane "Motrat Qiriazhi", gjithnjë e ka vlerësuar rolin e femrës shqiptare në shoqërinë e sotme. Ju përmendët vetëm dy emra, por unë do të shtoj se në aktivitetet e mëparshme ne kemi vlerësuar edhe figura

mjaft të njohura të artistit shqiptar si Vajza Zela, Nexhmije Pagarusha dhe Anita Take.

Për të vlerësuar rolin e femrës shqiptare në ditët tona, kemi zgjedhur 7-8 Marsin. Në këtë ditë ne nderojmë edhe mësuesit, pikërisht arritjet e atyre mësuesve që vazhdojnë profesionin e tyre me përkushtim edhe këtu në Amerikë. Gratë shqiptare kanë histori, ku sigurisht me veprën e tyre janë pjesë e historisë kombëtare. Dihet që artisti është ambasador i vendit të vet dhe roli i tij është që të përçojë vlerat e kulturës. Inva Mula është një ndër ata emrat më të njohur të



operas botërore dhe sigurisht edhe ne marrim pak krenari nga emri i saj. Të njëjtin rol prej shumë vitesh e deri më sot e luan Donika Bardha. Puna e saj ka bërë të mundur që nëpërmjet artit t'i tregojë botës së qytetëruar se kush janë shqiptarët. Ne vlerësojmë punën e grave në përgjithësi, sepse ato luftojnë për atë në të cilën besojnë. Mohojnë veten e tyre për të mbajtur familjen të qëndrueshme, e janë më të forta kur mendojnë se nuk kanë energji.

**Në njoftimet e publikuara në web-in e kësaj organizate, gjen shumë veprimtari kushtuar ngjarjeve që kanë lënë gjurmë në shoqërinë shqiptare, si Pavarësia e Kosovës, apo ngjarje si tragjedia e Gërdecit dhe përmbytjet e fundit në zonat e Shkodrës... Si i keni përjetuar këto ngjarje?**

Jam e bindur se të gjithë shqiptarët kudo në botë janë të lidhur shpirtërisht me atdheun. Të gjitha ngjarjet i kemi përjetuar dhe ndjekur me emocion. Jemi munduar që me punën tonë të ndikojmë jo vetëm në komunitet, por edhe në opinionin amerikan. Ngjarje të tilla si Pavarësia e Kosovës, kanë qenë historike për gjithë kombin shqiptar, e ne kemi qenë të pranishëm në çdo manifestim. Tragjedia e Gërdecit ishte ajo që na shkaktoi dhimbje për jetën e humbura. AAWO dhe bordi i saj u mblodhën në zyrën e konsullit Albert Jerasi, ku hapëm një llogari bankare dhe arritëm të grumbullojmë një fond të vogël.



Donika Bardha, "Gruaja e Vitit 2010"

*Presidentja e organizatës "Motrat Qiriazhi", flet për punën në ndihmë të shqiptarëve dhe nostalgjinë për rininë e saj në Vlorë*

## Puna

Të gjitha ngjarjet i kemi përjetuar dhe ndjekur me emocion. Jemi munduar që me punën tonë të ndikojmë jo vetëm në komunitet, por edhe në opinionin amerikan. Ngjarje të tilla si Pavarësia e Kosovës, kanë qenë historike për gjithë kombin shqiptar, e ne kemi qenë të pranishëm në çdo manifestim. Tragjedia e Gërdecit ishte ajo që na shkaktoi dhimbje për jetën e humbura



Në 2-vjetorin e pavarësisë së Kosovës, Viola Trebicka, Drita Shkurti, Loretta Stamo, Alda Mosko, Agathia Luka dhe Anna Kohen

**■ Dy femra**

Inva Mula është një ndër ata emrat më të njohur të operas botërore, dhe sigurisht edhe ne marrim pak krenari nga emri i saj. Të njëjtin rol, prej shumë vitësh e deri më sot e luan Donika Bardha. Puna e saj ka bërë të mundur që nëpërmjet artit t'i tregojë botës së qytetaruar se kush janë shqiptarët

Më pas dërguam përfaqësuesin tonë në Bashkinë e Vorës, ku iu dorëzua çeku familjes Deliu. Edhe në rastin e fundit të përmblytjeve në Shkodër dhe rrethinat e saj, jemi mbledhur dhe kemi dërguar informacion në të gjithë rrjetin tonë për të kontribuar për të përmblyturit. Unë personalisht, së bashku me një anëtare të bordit drejtues kemi marrë pjesë dhe kemi dhënë një çek në emër të AAWO në mbledhjen e organizuar për këtë rast nga Kisha katolike e New York-ut. (Dua të përmend një rast që është shumë domethënës, një vajzë, nxënëse në një nga shkollat e NY, në kohën e tragjedisë së Gërdecit bëri një fushatë në shkollën e saj dhe arriti të mbledhë një shumë simbolike dhe në një aktivitet të "Motrave Qiriazit" i solli. Sa nxënës shqiptarë ka në NY apo në tërë Amerikën, po sikur dhe ata të vepronin si bashkatdhetarja e tyre?)  
**Përmendët fillimet tuaja në krye të kësaj organizate. Vetëm pak vite më herët se të ishit atje, ju u larguat nga Shqipëria. Flasi pak për Vlorën, qytetin ku ju njihin gjerësisht. Ju jeni hebreje e rritur në këtë qytet bregdetar, të cilin e latë më pas për të jetuar përfundimisht në SHBA. Si ka qenë fëmijëria dhe rinia e hershme në Vlorë?**  
 U largova nga Shqipëria duke lënë pas kujtimet më të bukura të jetës sime, shoqet dhe shokët e rinisë me të cilët kishim ndarë shumë gëzime. Kujtimet janë të shumta dhe do ta filloj me një nga ato të

fëmijërisë. Edhe sot unë kujtoj kur ende isha fëmijë dhe rrija në plazh, vizatoja një anije me flamurin shqiptar dhe flamurin izraelit dhe shpresoja që një ditë këta flamuj do të valëvitëshin së bashku, dhe kështu ndodhi. Në ceremoninë e organizuar nga Bashkia e Vlorës për të më shpallur mua "Qytetare Nderi", faktikisht ishin të dy flamujt bashkë. Më ka mbetur në mendje imazhi i perëndimit të diellit, ku rrija dhe vizatoja. Gjithashtu Vlorë, duke qenë kaq e bukur si qytet, me detin Adriatik, të frymëzonte dhe të bënte shumë romantike. Rinia ishte periudha më e bukur:

**|| VAÇE ZELA**

...në plazh kishim kabina dhe aty vinin nga Tirana mikesha të familjes. Mbjaj mend që erdhi Vaçe Zela me një doktoreshë, mikeshë e familjes, e të dyja më merrnin, më ulnin në karrige sikur të isha kukulla e tyre. Vaçe Zela i binte kitarës dhe këndonim këngë që nuk i harroj kurrë...

Ishim klasa më e mirë e gjimnazit, me shokë që ishim si vëllezër dhe motra. Sot i kujtoj të gjithë me mall e dashuri. Me shokë time më të ngushtë mbaj lidhje të rregullta, e vizitoj dhe mundohem të jem pranë saj në çdo moment. Kur shkoj në Vlorë, madje nga larg kur shikoj qytetin mbushem me emocione, më rrënoqet mish, e shpeshherë lotoj. Vlorën e dua shumë, po aq shumë edhe qytetarët e saj dhe në tërësi të gjithë shqiptarët kudo që janë, sepse shqiptarët më shpëtuam prindërit në kohën e Luftës së Dytë

Botërore.  
**Për çfarë ndjeni mall më së shumti? Çfarë do të thotë ky qytet për ju?**  
 Ndjenja dhe malli janë motivi që më shtojnë ta dua këtë qytet. Janë ngjarje, momente dhe njerëz që në një mënyrë apo në një tjetër kanë qenë pjesë e jetës së familjes sime. E mbi të gjitha natyra e bukur e bregdetit. Pse të gjithë e duam detin? Deti shqipton diçka pa pushim, zëri i tij flet për shpirtin, të thërret - eja dhe jeto në zemrën time. Në plazh kishim kabina dhe flinim unë me gjyshen. Aty vinin nga Tirana edhe mikesha të familjes. Atë që mbaj mend ishte, kur erdhi Vaçe Zela me një doktoreshë, mikeshë e familjes. Ato më merrnin, më ulnin në karrige sikur të isha kukulla e tyre, dhe më rregullonin flokët e që ishin shumë kaçurrela. Vaçe Zela i binte kitarës dhe këndonim këngë që nuk i harroj kurrë. Për mua, Vaçja ka qenë këngëtarja më madhe. Më merr malli për muzikën shqiptare, për vallet e bukura dhe gjithmonë në aktivitetet nuk ndalem duke kërcyer. Ah, nostalgjia është si një ushtrim gramatike: ju gjeni kohën e tashme, por dhe të kryerën e shkuar.  
**Edhe pse e larguar, ju nuk ndaheni nga kjo pjesë e jetës suaj, pasi veprimtaritë rreth shqiptarëve janë kaq të pranishme në ditët tuaja. Ç'mund të thoni për raportet që mbani tashmë me këtë vend dhe njerëzit e tij?**  
 Jam e lumtur që Shqipëria përfundimisht u bë demokratike, dhe njerëzit nuk vuajnë më nga sëmundja e komunizmit. Hapja e kufijve dhe turizmi ishte një ëndërr që tani është një realitet. Vizitat e

time piktoreske.  
**Çfarë synoni me "Motrat Qiriazit" në të ardhmen?**  
 Duke bërë një biografi të shkurtër të të gjithë veprimtarisë, pa droje e them se Organizata e graus shqiptaro-amerikane "Motrat Qiriazit", është NËNA e komunitetit shqiptar në New York, sepse ajo ende vazhdon të ndihmojë fëmijët e saj. Dua të kujtoj që, në bashkëpunim me "Gift of Life International", ("Dhuratë për Jetën") kemi ndihmuar ardhjen e shumë fëmijëve nga Kosova dhe nga Shqipëria, për t'u shëruar nga defektet e lindura në zemër. Në total mund të them më shumë se 15 fëmijë. Nga këta, 7 nga Shqipëria, i dërguam në Itali, në bashkëpunim me Dr. Numillen nga spitali i "Nënë Terezës". Rastet kanë qenë të ndryshme, e njëri nga ato është ai i një vajze nga Shkodra, Amela Zadeja 9-vjeçare, e cila nëse nuk do të operohej, do të jetonte edhe 4 vite. Ndërsa këto ditë kam qenë e angazhuar me ndjekjen e procedurave të operacionit të një vajze 13-vjeçare nga Prishtina, që quhet Labentina. Tani për tani ne po punojmë mbi disa programe. Në bashkëpunim me "Easter Seals" dhe "Partnership for the homeless", po punojmë me moshën e tretë. Është viti i dytë që në bashkëpunim me "Fresh Air Fund" (Pondacioni "Ajri i Pastër"), kemi bërë të mundur që të dërgojmë për pushime verore falas fëmijë nga komuniteti shqiptar i New York-ut. Në bashkëpunim me "Allen Health Care Services", ne u krijujmë mundësinë shqiptarëve që pas marrjes së certifikatës si kujdestarë për të moshuarit, të punësohen. Sukseset e parë është arritur me përfundimin e një klase vetëm me shqiptarë në muajin shkurt 2010. Në të njëjtën kohë, për t'iu ardhur në ndihmë grave dhe vajzave shqiptare kemi bërë mamografi falas, të cilën e planifikojmë sipas vendit dhe kërkesave të shqiptarëve. Por veprimtaria jonë nuk ndalet këtu, ajo shtrihet dhe më gjerë, në fushën e artit dhe kulturës. Herë pas here ne organizojmë promovime të librave nga krijuesit shqiptarë në Amerikë, ekspozita të artit në fotografi dhe pikturë me artistë të këtuashëm edhe me artistë shqiptarë jashtë Amerikës. Është kënaqësi që t'i përmendim të gjitha këto, sepse ne normalisht, BËJMË ATË QË THEMI, POR NUK THEMI ATË QË BËJMË. Ju tani më dhatë mundësinë që aktualisht të themi atë që bëjmë.

